



Pranuar / Dostignut Punjenje / Pristiglo Received / Dostignut	21. 12. 2020	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org / Unit	3252/2020	Sasia Kolicina Quantity
		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.397/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtar, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.397/2020 të datës 08.12.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë rruga "Ahmet Krasniqi", Lagja Arbëria Nr. 2, në Prishtinë, kundër Vendimit me numër 01.Ref.Nr.45 të datës 25.11.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "pezullim nga puna", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.12.2020, mori këtë

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa më numër A.nr.397/2020 e datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 01.Ref.Nr.45 i datës 25.11.2020 i Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

III.OBLIGOHET Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin [REDACTED] në pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë sipas Vendimit me Nr.03/07 të datës 22/06/2020 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e 50% të pagës nga dita e pezullimit deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Ar sy e t i m

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me qëllim të zbatimit të Aktvendimit A.nr.1662/2020 të datës 09.10.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktvendimin AA.nr.611/2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, më datë 24.11.2020 ka nxjerr Vendim me numër 01.Ref.Nr.43 me të cilin ankuesin [REDAKTUAR] e ka kthyer në pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë duke i njohur edhe kompensimin e pagës së ndaluar në vlerën 50%.

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, më datë 25.11.2020 ka nxjerr Vendim me numër 01.Ref.Nr.45 me të cilin ankuesi pezullohet nga puna me 50% të pagës me arsyetim: për mos përmbushje të detyrave të punës, mosrespektim i afateve të përcaktuara në përmbushjen e detyrave të cilat kanë sjell pasoja të rënda, moszbatim i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale, dëmtim i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore, shkelje e detyrimeve të përcaktuar në këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, kryerja e veprimeve që cenojnë nëpunësit civil, institucioni apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Ankuesi [REDAKTUAR] kundër Vendimit me numër 01.Ref.Nr.45 të datës 25.11.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3005/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.12.2020 me numër protokollit 3005/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01.Ref.Nr.43 të datës 14.11.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Vendimin me numër 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Vendimin A.nr.265/2020 të datës 13.11.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01.Ref.Nr.45 të datës 14.11.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi fillimisht me Vendimin 01.Ref.Nr.20 të datës 09.09.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është pezulluar nga puna me 50% të pagës, mirëpo pas nxjerrjes së Aktvendimit A.nr.1662/2020 të datës 09.10.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktvendimit AA.nr.611/2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës është kthyer në vendin e tij të punës sipas Vendimit me numër 01.Ref.Nr.43 të datës 24.11.2020 të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, më datë 25.11.2020 ka nxjerr Vendim me numër 01.Ref.Nr.45 me të cilin ankuesi pezullohet nga puna me 50% të pagës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se: ministri nuk është personi kompetent për të bërë pezullimin me 50% të pagës së nëpunësit civil sepse kjo përgjegjësi është e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimi me numër 01.Ref.Nr.45 të datës 25.11.2020 i Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është në kundërshtim me nenin 47, 52 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar cilat janë rastet e pezullimit në këtë rast nuk janë përfill dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se ministri nuk është personi kompetent për të bërë pezullimin me 50% të pagës së nëpunësit civil sepse kjo përgjegjësi është e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, ka konstatuar që neni 46 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përcakton shkeljet disiplinore dhe ndarjen e tyre (rënda dhe të lehta), ndërsa nuk përcakton mënyrën e pezullimit të marrëdhënies së punës, sepse pezullimi i marrëdhënies së punës përcaktohet në bazë të nenit 56 dhe 57 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, qoftë sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të nëpunësit civil, kështu që asnjëra nga dispozitat e nenit 56 dhe 57 të këtij ligji nuk ka përcaktuar që nëpunësit civil mund t'i pezullohet marrëdhënia e punës me 50 % të pagës, ndërsa neni 58 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë parasheh specifikisht se kur nëpunësi përfiton 50% të pagës gjatë pezullimit, kjo përcaktohet vetëm në rastin *“nëse ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, që deklarohet nga vetë nëpunësi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e tij në një pozitë tjetër, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji”*, mbi këtë bazë Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë në dispozitat e tij nuk parasheh asnjë rrethanë tjetër të pezullimit të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil ku përfiton 50% të pagës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke ju referuar nenit 33 paragrafit 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasolershme”*, konstaton se pozita e ankuesit Sekretar i Përgjithshëm është pozitë e kategorisë së lartë drejtuese, kështu që për çdo supozim të shkeljeve të detyrave të punës procedura mund të fillohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë vetëm në Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë siç parashihet me nenin 49 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 23 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, dhe në asnjë formë të merret vendim për pezullim të marrëdhënies së punës me 50% të pagës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pezullimi i nëpunësit civil ndaj të cilit supozohet se ka bërë shkelje të detyrave të punës mund të bëhet vetëm nga Komisioni Disiplinor, në rastin konkret të ankuesit nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë siç përcaktohet me 48 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”*, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit se ministri nuk është kompetent për të nxjerr një vendim të tillë është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi me numër 01.Ref.Nr.45 të datës 25.11.2020 i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është në kundërshtim me nenin 47, 52 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar cilat janë rastet e pezullimit në këtë rast nuk janë përfill dispozitat ligjore në fuqi, ka konstatuar se Vendimi me numër 01.Ref.Nr.45 të datës 25.11.2020 i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nuk përmban elementet e një akti administrativ siç përcaktohet me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1,1 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse në pjesën hyrëse të tij nuk është përcaktuar saktë baza ligjore e nxjerrjes së këtij vendimi po ashtu në pjesën përmblylëse nuk është përcaktuar saktë organin se ku pala mund të drejtohet me ankesë kundër këtij akti, Andaj sipas këtyre rrethanave Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër 01.Ref.Nr.45 të datës 25.11.2020 i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është nxjerr në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse Vendimi me numër 01.Ref.Nr.45 të datës 25.11.2020 i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është nxjerr nga organi që nuk ka kompetencë dhe është edhe në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë”*, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është i obliguar që ankuesin [REDAKTUAR] ta kthejë në pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë sipas Vendimit me Nr.03/07 të datës 22/06/2020 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e 50% të pagës nga dita e pezullimit deri në zbatimin e këtij vendimi.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.397/2020; datë 21.12.2020

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit [REDACTED]
- Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.